



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 21 prill 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i redaktuar publik i vendimit të parë mbi pjesëmarrjen e viktimave

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Dejvid Hupër

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	2
II.	PARASHTRIMET	4
III.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE	5
	A. Parashtrimi i kërkesës dhe pranimi në proces	5
	B. Pjesëmarrja në procedurën paraprake	6
	C. Masat mbrojtëse	7
IV.	DISKUTIM	8
	A. Plotësia e kërkesave	8
	B. Pranueshmëria e kërkesave	10
	(a) Personi fizik	13
	(b) Krimi ose krimet e pretenduara	13
	(c) Dëmi i pësuar personalisht si rezultat i drejtpërdrejtë i një krimi të përfshirë në aktakuzë	16
	(d) Përfundim	20
	C. Masat mbrojtëse	20
	(a) Formularët e kërkesës	22
	(b) Parashtruesit e kërkesave të pranuar	23
	(c) Parashtruesit e kërkesave të refuzuara	25
	D. Grupimi dhe përfaqësimi ligjor i përbashkët	26
	E. Pjesëmarrja në procedurën paraprake	29
V.	VENDIMI	30

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenet 22, 39(1), (11) dhe (13) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe me rregullat 80, 95(2)(h)-(i), 113 dhe 114 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), merr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Hashim Thaçit ("z. Thaçi"), Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit ("z. Krasniqi") (bashkërisht të quajtur këtu "të akuzuarit") me një vendim të arsyetuar ("Vendimi i Konfirmimit").²

2. Më 30 tetor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") parashtroi aktakuzën e konfirmuar ("Aktakuza e Konfirmuar"),³ me redaktimet e autorizuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁴

3. Më 11 dhjetor 2020, ZPS-ja parashtroi versionet e redaktuara konfidenciale të përmbledhjeve të hollësishme në bazë të rregullës 86(3)(b) të Rregullores ("Përmbledhja sipas rregullës 86(3)(b)").⁵

4. Më 4 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori një vendim kornizë mbi parashtrimin e kërkesave nga viktimat ("Vendimi Kornizë"), ku, ndër të tjera, i jepte

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00026/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim i redaktuar publik për konfirmimin e aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit* ("Vendimi i Konfirmimit"), 26 tetor 2020, publik.

³ KSC-BC-2020-06, F00034/A01, Prokurori i Specializuar, *Aktakuza* ("Aktakuza e Konfirmuar"), 30 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. *Shih edhe* F00134, Prokurori i Specializuar, *Version me më pak redaktime i Aktakuzës së Redaktuar*, KSC-BC-2020-06-F00045-A02, 4 nëntor 2020, 11 dhjetor 2020, konfidencial.

⁴ Vendimi i Konfirmimit, para. 521(c)-(d).

⁵ KSC-BC-2020-06, F00136, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i përmbledhjeve të redaktuara konfidenciale sipas rregullës 86(3)(b)*, 11 dhjetor 2020, publik, me shtojcat konfidenciale 1-2.

urdhër Zyrës për Pjesëmarrjen e Viktimave (“ZPV”) që brenda datës 15 shkurt 2021, t’u paraqiste raportin e parë në pajtim me rregullën 113(2) të Rregullores, Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe palëve lidhur me kërkesat e dorëzuara dhe të paraqiste periodikisht raporte të mëtejshme, nëse do të kishte, jo më vonë se dorëzimi i parashtrimit të Mbrojtjes në pajtim me rregullën 95(5) të Rregullores.⁶

5. Më 15 shkurt 2021, ZPV-ja paraqiti raportin e saj të parë mbi kërkesat e ardhura (“raporti i parë”) me nëntëmbëdhjetë shtojca rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* të cilat përmbanin një tabelë me shtatëmbëdhjetë parashtrues të kërkesave për të cilët rekomandohej pranimi, një tabelë me një parashtrues kërkesë për të cilin nuk rekomandohej pranimi dhe përmbledhjet e kërkesave për gjithsej tetëmbëdhjetë parashtrues kërkesë.⁷

6. Më 26 shkurt 2021, Mbrojtja e z. Thaçi, dhe më 1 mars 2021, Mbrojtja e z. Krasniqi (bashkërisht të quajtur “Mbrojtja”) parashtruan përgjigjet e tyre për raportin e parë.⁸

7. Më 1 mars 2021, ZPS-ja parashtroi vërejtjet e saj për raportin e parë.⁹

8. Më 1 prill 2021, ZPV-ja parashtroi një shtesë të raportit të parë (“shtesa”).¹⁰

⁶ KSC-BC-2020-06, F00159, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim kornizë mbi parashtrimin e kërkesave nga viktimat* (“Vendimi Kornizë”), 4 janar 2021, publik, para. 56(c)-(e).

⁷ KSC-BC-2020-06, F00203, Zyra për Pjesëmarrjen e Viktimave, *Raporti i parë i Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi kërkesat e viktimave për pjesëmarrje në proces* (“Raporti i Parë”), 15 shkurt 2021, publik, para. 8, me shtojcat rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* 1-19. ZPV-ja më tej i ka bërë të ditur Gjykatësit të Procedurës Paraprake se raporti i parë mund t’u zbulohet edhe palëve dhe publikut. *Shih* Raporti i parë, para. 7.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00208, Mbrojtja e z. Thaçi, *Përgjigjja e Mbrojtjes së Thaçit ndaj raportit të parë të Zyrës Administrative mbi kërkesat e viktimave për pjesëmarrje në proces* (“Përgjigjja e Thaçit”), 26 shkurt 2021, publik; F00209, Mbrojtja e z. Krasniqi, *Përgjigjja e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj raportit të parë të ZPV-së* (“Përgjigjja e Krasniqit”), 1 mars 2021, publik, me shtojcën 1, publike.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00210, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë mbi raportin e parë të Zyrës Administrative mbi kërkesat e viktimave* (“Përgjigjja e ZPS-së”), 1 mars 2021, publik.

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00241, Zyra për Pjesëmarrjen e Viktimave, *Shtesë e raportit të parë të Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi kërkesat e viktimave për pjesëmarrje në proces me rekomandim për grupim* (“Shtesa”), 1 prill 2021, publike me shtojcën 1, konfidenciale edhe *ex parte*.

9. Më 14 prill 2021, Mbrojtja e z. Thaçi iu përgjigj Shtesës.¹¹

II. PARASHTRIMET

10. ZPV-ja rekomandon që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të miratojë shtatëmbëdhjetë kërkesa dhe të refuzojë një kërkesë.¹² ZPV-ja rekomandon më tej mosnxjerrjen publike të të dhënave identifikuese të të gjithë parashtruesve të kërkesave dhe gjithashtu që të dhënat identifikuese të parashtruesve të kërkesave të cilët janë me banim në Kosovë dhe të parashtruesve të kërkesave me kombësi shqiptare familjet e të cilëve janë në Kosovë, të mbahen anonime për mbrojtësit e akuzuarve dhe të akuzuarit.¹³

11. Mbrojtja e z. Thaçi parashtron vërejtje të përgjithshme në lidhje me pranueshmërinë e kërkesave dhe masat e kërkuara mbrojtëse.¹⁴

12. Mbrojtja e z. Krasniqi parashtron vërejtje të përgjithshme në lidhje me kriteret e parashikuara në rregullën 113 të Rregullores, masat mbrojtëse dhe grupimin e parashtruesve të kërkesave.¹⁵ Mbrojtja e z. Krasniqi parashtron edhe një tabelë me përmbledhje të informacioneve të dhëna për parashtruesit e kërkesave në raportin e parë.¹⁶

13. ZPS-ja parashtron se nuk ka kundërshtime për zbatimin dhe interpretimin e kriterëve që kanë të bëjnë me pranueshmërinë, përfaqësimin e përbashkët dhe masat mbrojtëse në raportin e parë.¹⁷

¹¹ KSC-BC-2020-06, F00245, Mbrojtja e z. Thaçi, *Përgjigja e z. Thaçi ndaj shtesës së raportit të parë të Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi kërkesat e viktimave për pjesëmarrje në proces me rekomandim për grupim ("Përgjigja e Thaçit ndaj Shtesës")*, 14 prill 2021, publike.

¹² Raporti i parë, para. 48-49.

¹³ Raporti i parë, para. 61-62.

¹⁴ Përgjigja e Thaçit, para. 7-25, 27-29.

¹⁵ Përgjigja e Krasniqit, para. 17-32.

¹⁶ Përgjigja e Krasniqit, Shtojca 1.

¹⁷ Përgjigja e ZPS-së, para. 1.

14. Në Shtesë, ZPV-ja bën parashtrime të mëtejshme mbi grupimin e parashtruesve të kërkesave dhe përfaqësimin e përbashkët juridik.¹⁸ ZPV-ja bën të ditur edhe se një parashtrues kërkesë, viktimë 05/06, ka vdekur pas parashtrimit të raportit të parë dhe se për këtë do të ketë një parashtrim.¹⁹

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

A. PARASHTRIMI I KËRKESËS DHE PRANIMI NË PROCES

15. Në pajtim me nenin 22(1) të Ligjit dhe me rregullën 2 të Rregullores, viktimë është personi fizik që ka pësuar dëm fizik, material apo mendor si pasojë e drejtpërdrejtë e një veprë penale që bie brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara ("DHS") dhe që pretendohet në një aktakuzë të konfirmuar nga gjykatësi i procedurës paraprake ("SC").

16. Në pajtim me rregullën 113(1) të Rregullores, pas konfirmimit të aktakuzës dhe në kohë të mjaftueshme përpara hapjes së çështjes, një person që pretendon se është viktimë e një veprë penale të pretenduar në aktakuzë, mund të bëjë kërkesë për pranim si viktimë pjesëmarrëse në proces ("VPP"), ku saktëson se si i përmbush kriteret si viktimë dhe jep vendin dhe datën e veprës penale që pretendohet se ka shkaktuar dëm. Formularët e kërkesave nuk u zbulohen palëve.

17. Në pajtim me rregullën 113(2) të Rregullores, ZPV-ja regjistron dhe vlerëson kërkesat dhe ia dorëzon Gjykatësit të Procedurës Paraprake, së bashku me një rekomandim për pranueshmërinë dhe përfaqësimin e përbashkët, si dhe një kërkesë për masa mbrojtëse sipas rregullës 80 të Rregullores, sipas rastit. ZPV-ja duhet t'u parashtrojë edhe një raport konfidencial palëve, pa nxjerrë të dhëna identifikuese të parashtruesve të kërkesave.

¹⁸ Shtesa, para.11-32.

¹⁹ Shtesa, poshtëshënimi 10.

18. Në pajtim me rregullën 113(3) të Rregullores, palët mund të bëjnë parashtrime vetëm në lidhje me aspektin ligjor të pranueshmërisë dhe përfaqësimit të përbashkët.

19. Në pajtim me rregullat 95(2)(i) dhe 113(4)-(5) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka dhënë prova *prima facie* për dëmin e pësuar si rezultat i drejtpërdrejtë i një veprë penale të përfshirë në aktakuzë dhe nxjerr një vendim të arsyetuar me anë të të cilit miraton ose refuzon pranimin në proces. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos edhe për përfaqësimin e përbashkët, si dhe për çfarëdo kërkesë për masa mbrojtëse. Vendimi u njoftohet parashtruesit të kërkesës, ZPV-së dhe palëve.

20. Në pajtim me rregullën 113(6) të Rregullores, personat të cilëve u refuzohet kërkesa kanë të drejtën e apelimit të vendimit brenda katërmbëdhjetë (14) ditësh pas njoftimit.

21. Në pajtim me rregullën 113(8) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, pasi konsultohet me ZPV-në, vendos nëse VPP-të të ndahen në grupe me përfaqësim të përbashkët, duke marrë parasysh: (a) konflikte interesash që mund të pengojnë përfaqësimin e përbashkët; (b) interesa të ngjashme që mund të lehtësojnë përfaqësimin e përbashkët; dhe (c) të drejtat e të akuzuarit dhe interesat për një gjykim të shpejtë e të drejtë.

B. PJESËMARRJA NË PROCEDURËN PARAPRAKE

22. Në pajtim me nenin 22(3) të Ligjit, interesi personal dhe të drejtat e VPP-së në procedurën penale para DHS-së janë njoftimi, pranimi dhe zhdëmtimi.

23. Në pajtim me rregullën 113(7) të Rregullores, kur viktimave u miratohet e drejta e pjesëmarrjes në proces, grupit të VPP-ve Administratori i cakton një mbrojtës të viktimave në përputhje me Direktivën për Mbrojtësit.

24. Në pajtim me nenin 22(6) të ligjit dhe rregullën 114(1) të Rregullores, VPP-të i ushtrojnë të drejtat e tyre përmes një mbrojtësi të viktimave të caktuar, ndër të tjera gjatë procedurës paraprake, kur preken interesat personale të VPP-ve dhe vetëm kur kjo nuk cenon apo nuk bie ndesh me të drejtat e të akuzuarit.

25. Në pajtim me rregullën 114(4) të Rregullores, nëse është e nevojshme dhe varësisht nga rrethanat, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxjerr udhëzime të posaçme që rregullojnë pjesëmarrjen e VPP-ve në procedurën paraprake, në pajtim me nenin 22(3) dhe (6) të Ligjit.

26. Në pajtim me rregullën 114(2) të Rregullores, mbrojtësi i viktimave mund të jetë i pranishëm në procedurën paraprake nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake e çmon të arsyeshme, me qëllim garantimin e interesave personale dhe të drejtave të VPP-ve, në përputhje me nenin 22(3) të Ligjit.

27. Në pajtim me rregullën 114(3) të Rregullores, mbrojtësi i viktimave ka qasje në materiale konfidenciale, përveç nëse Rregullorja parashikon ndryshe, ose sipas vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Mbrojtësi i viktimave i informon rregullisht klientët për zhvillimet përkatëse në lidhje me çështjen gjyqësore, në një mënyrë që nuk zbulon informacione konfidenciale.

28. Në pajtim me rregullën 114(4) të Rregullores, kurdoherë që preken interesat personale të VPP-ve dhe nëse Rregullorja nuk parashikon ndryshe, mbrojtësi i viktimave, nën mbikëqyrjen e trupit gjykues, bën parashtrime me gojë dhe me shkrim.

C. MASAT MBROJTËSE

29. Në pajtim me nenin 39(11) të Ligjit dhe rregullën 95(2)(h) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, kur është e nevojshme, mund të marrë vendime mbi mocionet në lidhje me mbrojtjen dhe jetën private të viktimave dhe të dëshmitarëve, të protokolluara përpara kalimit të dosjes gjyqësore.

30. Në pajtim me nenin 80(1) të Rregullores, një panel, *proprio motu* ose me kërkesë, mund të urdhërojë masa mbrojtëse për mbrojtjen, sigurinë, mirëqenien fizike dhe mendore, dinjitetin dhe privatësinë, ndër të tjera, të viktimave pjesëmarrëse në procese.

31. Në pajtim me rregullën 80(4) të Rregullores, masa të tilla mund të përfshijnë mosnxjerrjen për palët e materialit apo informacionit që mund të çojë në nxjerrjen e identitetit të dëshmitarit apo viktimës pjesëmarrëse në procesin gjyqësor.

IV. DISKUTIM

A. PLOTËSIA E KËRKESAVE

32. ZPV-ja parashtron se shumica e kërkesave kanë ardhur me postë elektronike, ndërsa tetë kërkesa janë dërguar nga dy avokatë të ndryshëm.²⁰ ZPV-ja më tej bën të ditur se, përveç dokumentacionit/informacionit shtesë që duhet dorëzuar nga një sërë parashtruesish të kërkesave,²¹ të gjitha kërkesat e parashtruara me raportin e parë mund të konsiderohen formalisht të plota.²²

33. Mbrojtja e z. Thaçi parashtron se kërkesat duhen rrëzuar kur janë të paplota, kur ka mospërputhje midis apo brendapërbrenda dokumenteve të identifikimit dhe formularit të kërkesës, kur dëmi i pretenduar bie jashtë kuadrit kohor ose gjeografik të akuzave të ngritura ose kur nuk bëhen të ditura të dhënat specifike apo vendndodhja e ngjarjes së pretenduar.²³

34. Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton konstatimin e tij në vendimin kornizë, sipas të cilit një kërkesë është e plotë nëse përmbush këto kritere: (i) ka dëshmi të

²⁰ Raporti i parë, para. 6. Njëri parashtrues kërkesë (Viktima 15/06) e ka tërhequr kërkesën e vet, e cila, për këtë arsye, nuk është përfshirë raportin e parë. *Shih* Raporti i parë, para. 6.

²¹ Raporti i parë, para. 13.

²² Raporti i parë, para. 14.

²³ Përgjigjja e Thaçit, para. 8.

mjaftueshme të identitetit dhe, sipas rastit, të lidhjes familjare dhe/ose të kujdestarisë ligjore; (ii) të dhënat personale janë të plota; (iii) janë plotësuar të gjitha rubrikat përkatëse të formularit të kërkesës²⁴; (iv) janë treguar mjaftueshëm qartë data/periudha dhe vendndodhja e krimeve si edhe dëmi i pësuar; (v) është dorëzuar dokumentacion përkatës dhe i mjaftueshëm, për aq sa është e mundur; dhe (vi) kërkesa është nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës ose nga kujdestari i tij ligjor.²⁵

35. Duke marrë parasysh sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson nëse kërkesat e paraqitura janë të plota dhe nëse japin informacione të mjaftueshme për të mundësuar një konstatim sipas rregullës 113(4) të Rregullores. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kujton ZPV-së se fraza “për aq sa është e mundur” në lidhje me kriterin “v” sa i takon parashtrimin të dokumentacionit përkatës dhe të mjaftueshëm do të thotë se ZPV-ja duhet të kontrollojë gjithmonë nëse ky dokumentacion është i disponueshëm dhe, kur është, ZPV-ja duhet të kërkojë dorëzimin e materialeve të tilla.²⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake më tej vëren se, në mungesë të një parashtrimi nga ana e ZPV-së ku do të vërtetohej vdekja e viktimës 05/06 dhe do të bëheshin parashtrime të tjera shtesë, kjo kërkesë nuk merret në analizë në këtë vendim.²⁷

36. Pasi shqyrtoi formularët e kërkesave, përmbledhjet e kërkesave dhe dokumentacionin mbështetës, kur ka, Gjykatësi i Procedurës Paraprake bën

²⁴ Formulari i kërkesë për pranim si viktimë pjesëmarrëse në proces gjyqësor, gjendet në faqen në internet të DHS-së.

²⁵ Vendimi Kornizë, para. 22.

²⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren në lidhje me këtë se viktimat 01/06, 02/06, 03/06 dhe 04/06 kanë bërë të ditur se zotërojnë dokumentacion mbështetës që vërteton dëmin, mirëpo ZPV-ja ka bërë të ditur shprehimisht në përmbledhjet përkatëse të kërkesave se nuk është kërkuar një dokumentacion i tillë (*shih* Raporti i parë, shtojcat 2-6). Edhe pse Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se, për këto kërkesa në fjalë, informacionet e dorëzuara janë të mjaftueshme për konstatimet e bëra në këtë vendim, ZPV-së i kërkohet që në raportet e ardhshme të respektojë kriteret lidhur me dokumentacionin mbështetës.

²⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se ZPV-ja ka kaluar në *Legal Workflow* certifikatën e vdekjes së viktimës 05/06 pa një parashtrim shoqëruar.

konstatimet në vijim. Së pari, të shtatëmbëdhjetë²⁸ kërkesat japin dëshmi identiteti të mjaftueshme dhe të dhënat personale, bëjnë të ditur me qartësi të mjaftueshme datën/periudhën dhe vendndodhjen e krimeve si edhe dëmin e pësuar dhe kanë nënshkrimin e vlefshëm. Së dyti, në lidhje me viktimat 08/06, 09/06, 10/06, 11/06, 12/06, 13/06, 14/06, 16/06, 17/06, 18/06 dhe 19/06, është paraqitur edhe dëshmi e mjaftueshme e lidhjes familjare.²⁹ Së treti, megjithëse është dorëzuar dokumentacion lidhur me dëmin e pësuar vetëm nga viktimat 04/06, 07/06, 08/06 dhe 17/06,³⁰ përshkrimi i hollësishëm i bërë nga parashtruesit e kërkesave sa u takon ngjarjeve dhe dëmit të pësuar ka qenë i mjaftueshëm për të arritur në konstatimet përkatëse.

37. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se shtatëmbëdhjetë kërkesat janë të plota dhe, rrjedhimisht, pranueshmëria e tyre mund të vlerësohet.

B. PRANUESHMËRIA E KËRKESAVE

38. ZPV-ja parashtron se: (i) të gjithë parashtruesit e kërkesave kanë dorëzuar dokumentacion të vlefshëm si persona fizikë;³¹ (ii) veprimet e përshkruara në shtatëmbëdhjetë kërkesat duket se përbëjnë krime brenda Aktakuzës së Konfirmuar, në lidhje me krimet e pretenduara në të ose në lidhje me kuadrin gjeografik dhe kohor të Aktakuzës së Konfirmuar, pra në Kosovë dhe në zonat e Shqipërisë së Veriut midis marsit 1998 dhe shtatorit 1999;³² (iii) gjashtë parashtrues kërkesë kanë pësuar dëm si viktima të drejtpërdrejta dhe njëmbëdhjetë parashtrues kërkesë kanë pësuar dëm si

²⁸ Ky numër nuk përfshin kërkesën e viktimës 05/06 për arsyet e shprehura në paragrafin 35.

²⁹ Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren mospërputhje të vogla në dukje sa i takon lidhjes familjare në kërkesën e viktimës 19/06, por mendon se përshkrimi i hollësishëm i parashtruesit të kërkesës dhe dokumentacioni i dorëzuar dëshmojnë në mënyrë bindëse lidhjen familjare të parashtruesit të kërkesës me viktimën e ndjerë.

³⁰ Raporti i parë, para. 38, 40-41, 46.

³¹ Raporti i parë, para. 22.

³² Raporti i parë, para. 23-30.

viktima të tërthorta pas vdekjes ose zhdukjes së një familjari të afërt;³³ dhe (iv) ka prova të lidhjes shkak-pasojë midis dëmit të pësuar nga të gjithë parashtruesit e kërkesave që ZPV-ja rekomandon të pranohen dhe një krimi të përfshirë në Aktakuzën e Konfirmuar.³⁴ Mbi këtë bazë, ZPV-ja i rekomandon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të miratojë shtatëmbëdhjetë kërkesa (viktimat 01/06, 02/06, 03/06, 04/06, 05/06, 07/06, 08/06, 09/06, 10/06, 11/06, 12/06, 13/06, 14/06, 16/06, 17/06, 18/06 dhe 19/06)³⁵ dhe të rrëzojë një kërkesë (viktima 06/06).³⁶

39. Mbrojtja e z. Thaçi parashtron se dëmi i pretenduar nga parashtruesit e kërkesave duhet të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e një krimi të përfshirë në Aktakuzën e Konfirmuar dhe, rrjedhimisht, çdo parashtruesi kërkesë duhet t'i kërkojë të dëshmojë se ka prova *prima facie* të dëmit të ardhur prej krimeve për të cilat ngrihet akuzë dhe të cilat pretendohet se kanë ndodhur në vendet e renditura shprehimisht në Aktakuzën e Konfirmuar, në veçanti në Listat A, B dhe C të saj.³⁷

40. Mbrojtja e z. Krasniqi parashtron se lejimi i pjesëmarrjes së viktimave që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me datat dhe vendndodhjet e përmendura në aktakuzë bën ndesh me të drejtat e të akuzuarve, sepse i zgjeron pashmangshmërisht parametrat e çështjes gjyqësore përtej kufijve të akuzave të ngritura.³⁸

41. ZPS-ja parashtron se Aktakuza e Konfirmuar i ka përcaktuar qartë parametrat kohorë, gjeografikë dhe lëndorë, të cilat e kufizojnë siç duhet objektin e viktimave të pranueshme *prima facie*.³⁹

³³ Raporti i parë, para. 33-36.

³⁴ Raporti i parë, para. 37.

³⁵ Raporti i parë, para. 48.

³⁶ Raporti i parë, para. 49.

³⁷ Përgjigja e Thaçit, para. 9, 19.

³⁸ Përgjigja e Krasniqit, para. 21.

³⁹ Përgjigja e ZPS-së, para. 2.

42. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton konstatimin e tij në vendimin kornizë sipas të cilit një viktimë që paraqet kërkesë pranohet të marrë pjesë në proces nëse ka prova *prima facie* se:

- (a) parashtruesi i kërkesës është person fizik;
- (b) parashtruesi i kërkesës ka përshkruar në kërkesë veprime që duken se përbëjnë një krim brenda Aktakuzës së Konfirmuar;
- (c) parashtruesi i kërkesës ka pësuar personalisht dëm; dhe
- (d) dëmi ka qenë rezultat i drejtpërdrejtë i një krimi të përfshirë në Aktakuzën e Konfirmuar.⁴⁰

43. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton më tej se vlerësimi i kriterëve të lartpërmendura të pranueshmërisë bëhet mbi bazë *prima facie*.⁴¹ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton informacionet dhe materialet mbështetëse të dorëzuara rast pas rasti, duke marrë parasysh: (i) të gjitha rrethanat përkatëse siç duken në pamje të parë,⁴² përfshirë edhe përmbajtjen e Aktakuzës së Konfirmuar, dhe, sipas rastit, të Përmbledhjes sipas rregullës 86(3)(b) dhe të Vendimit të Konfirmimit; dhe (ii) koherencën e brendshme të kërkesës,⁴³ përfshirë formularin e kërkesës, përmbledhjen e kërkesës dhe dokumentacionin mbështetës të dorëzuar. Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk bën vlerësim material të besueshmërisë apo saktësisë së informacioneve dhe provave të paraqitura.⁴⁴ Gjithsesi, Gjykatësi i Procedurës

⁴⁰ Vendimi Kornizë, para. 28.

⁴¹ Vendimi Kornizë, para. 29.

⁴² Vendimi Kornizë, para. 29.

⁴³ Vendimi Kornizë, para. 29.

⁴⁴ Për ngjashmëri, ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-1119, Trial Chamber I, [Decision on Victims' Participation](#) ("Lubanga Decision on Victim Participation"), 18 January 2008, para. 99; *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-1862, Trial Chamber III, [Decision on 270 Applications by Victims to Participate in the Proceedings](#), 25 October 2011, para. 27.

Paraprake nuk mbështetet në informacione apo materiale mbështetëse të cilat janë qartësisht joautentike.⁴⁵

(a) Personi fizik

44. Siç thuhet në paragrafin 37, Gjykatësi i Procedurës Paraprake bindet se të shtatëmbëdhjetë parashtruesit e kërkesave kanë paraqitur dëshmi të mjaftueshme identiteti dhe janë persona fizikë.

(b) Krimi ose krimet e pretenduara

45. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton këtu konstatimet e bëra prej tij në Vendimin Kornizë se “krimi” në lidhje me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se është viktimë duhet të jetë një prej krimeve të përfshira në Aktakuzën e Konfirmuar.⁴⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton më tej se parashtruesi i kërkesës duhet të përshkruajë, sa më konkretisht, vendin dhe kohën e ngjarjes dhe, nëse është e mundur, çdo kryes të pretenduar të pranishëm në vendin e ngjarjes apo të përfshirë në ngjarje.⁴⁷ Këto kritere tregojnë qartë se krimi apo krimet në lidhje me të cilin apo të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se është viktimë duhet të jenë brenda parametrave materialë, gjeografikë dhe kohorë të akuzave të ngritura në Aktakuzën e Konfirmuar.⁴⁸ Përmendjet e përgjithësuara të krimeve të tjera në

⁴⁵ Për ngjashmëri, KSC-BC-2020-06, F00026/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni i redaktuar publik i vendimit për konfirmimin e aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, para. 50.

⁴⁶ Vendimi Kornizë, para. 32.

⁴⁷ Vendimi Kornizë, para. 32.

⁴⁸ Duke mbajtur gjithësi parasysh kontekstin e ndryshëm procedural, për ngjashmëri, ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-1432, Appeals Chamber, [Judgment on the Appeals of the Prosecutor and the Defence Against Trial Chamber I's Decision on Victims' Participation of 18 January 2008](#) (“Lubanga Appeal Decision on Victim Participation”), 11 July 2008, paras 58, 62; *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-449, Trial Chamber VI, [Decision on Victims' Participation in Trial Proceedings](#) (“Ntaganda Decision on Victims' Participation”), 6 February 2015, para. 43; *Prosecutor v. Al Hassan*, ICC-01/12-01/18-37-tENG, Pre-Trial Chamber I, [Decision Establishing the Principles Applicable to Victims' Applications for Participation](#),

Aktakuzën e Konfirmuar që janë pjesë e ndonjë informacioni kontekstual apo përshkrimi të elementeve kontekstuale të krimeve të luftës apo të krimeve kundër njerëzimit nuk përfshihen brenda fushëveprimit të rregullave 2 dhe 113(1) të Rregullores, pavarësisht nëse përmendje të tilla kanë të bëjnë me krime të ngjashme me ato që përbëjnë akuzat. Çdo interpretim i ndryshëm do të çonte në pranimin e VPP-ve të cilët nuk do të kishin lidhje me akuzat e specifikuar në Aktakuzën e Konfirmuar.

46. Mbështetur në sa më lart dhe pas shqyrtimit të të gjitha kërkesave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se nëntë parashtrues kërkesë pretendojnë se janë viktimë e një krimi të pretenduar në Aktakuzën e Konfirmuar, siç parashikohet në rregullat 2 dhe 113(1) të Rregullores. Kështu, viktimat 01/06, 02/06, 03/06 dhe 04/06 pretendojnë se janë viktima të krimeve që pretendohet se janë kryer në [REDAKTUAR], komuna [REDAKTUAR].⁴⁹ Viktima 07/06 pretendon se është viktimë e krimeve që pretendohet se janë kryer në [REDAKTUAR], komuna [REDAKTUAR].⁵⁰ Viktimat 16/06, 17/07 dhe 18/06 pretendojnë se janë viktima të krimeve që pretendohet se janë kryer kundër familjarit të tyre të afërm në [REDAKTUAR], komuna [REDAKTUAR].⁵¹ Viktima 19/06 pretendon se është viktimë e krimeve që pretendohet se janë kryer kundër një familjari të afërm në [REDAKTUAR] komuna [REDAKTUAR] dhe në një vendndodhje tjetër të përfshirë në Aktakuzën e Konfirmuar.⁵² Së fundi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se krimet e përshkruara nga parashtruesit e lartpërmendur të kërkesave bien brenda periudhës përkatëse kohore të parashikuar për secilën vendndodhje të lartpërmendur, të përfshirë në Aktakuzën e Konfirmuar.⁵³

24 May 2018, paras 27, 48; *Prosecutor v. Yekatom and Ngaïssona*, ICC-01/14-01/18-738, [Decision on Victims' Participation in Trial Proceedings](#), 23 November 2020, para 20-21.

⁴⁹ [REDAKTUAR].

⁵⁰ [REDAKTUAR].

⁵¹ [REDAKTUAR].

⁵² [REDAKTUAR].

⁵³ [REDAKTUAR].

47. Sa i takon viktimës 12/06, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se informacionet e paraqitura janë të pamjaftueshme për një konstatim *prima facie* nëse krimi viktimë e të cilit pretendon të jetë parashtruesi i kërkesës, përmendet në Aktakuzën e Konfirmuar. Në veçanti, viktima 12/06 pretendon se është viktimë e një krimi që pretendohet se është kryer kundër një familjari të afërt në [REDAKTUAR] komunës [REDAKTUAR]. Edhe pse informacionet e paraqitura tregojnë qartë se krimi i pretenduar nuk përfshihet brenda kuadrit të akuzave të [REDAKTUAR] në lidhje me këtë vendndodhje,⁵⁴ informacionet nuk mundësojnë një konstatim nëse krimi mund të përfshihet brenda kuadrit të akuzave të [REDAKTUAR] të ngritura për të njëjtën vendndodhje.⁵⁵ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos shtyrjen e konstatimit lidhur me kërkesën e viktimës 12/06 dhe e udhëzon ZPV-në t'i drejtohet parashtruesit të kërkesës për të marrë më shumë informacione lidhur me rrethanat e krimeve të pretenduara.

48. Sa u takon parashtruesve të kërkesave të tjera, pra viktimave 06/06, 08/06, 09/06, 10/06, 11/06, 13/06 dhe 14/06, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se krimet viktimave të cilave pretendojnë se janë, nuk përfshihen brenda kuadrit kohor, gjeografik dhe material të akuzave të ngritura në Aktakuzën e Konfirmuar, dhe për rrjedhojë bien jashtë fushëveprimit të rregullave 2 dhe 113(1) të Rregullores. Kjo nuk cenon asnjë vendim procedural të ardhshëm sa i takon pranueshmërisë së kërkesave të tyre, përfshirë edhe në lidhje me dëmin që mund të kenë pësuar si pasojë e krimeve të përshkruara, pas një ndryshimi të mundshëm të Aktakuzës së Konfirmuar.

49. Si rrjedhojë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e shtyn për më vonë marrjen e një vendimi për kërkesën e viktimës 12/06 dhe konstaton, më tej, se kërkesat e viktimave 06/06, 08/06, 09/06, 10/06, 11/06, 13/06 dhe 14/06 janë të papranueshme. Kriteret e tjera

⁵⁴ [REDAKTUAR].

⁵⁵ [REDAKTUAR].

të pranueshmërisë do të vlerësohen vetëm në lidhje me kërkesat e viktimave 01/06, 02/06, 03/06, 04/06, 07/06, 16/06, 17/06, 18/06 dhe 19/06.

(c) Dëmi i pësuar personalisht si rezultat i drejtpërdrejtë i një krimi të përfshirë në aktakuzë

50. Në lidhje me dëmin e pësuar personalisht nga viktima, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton këtu konstatimin e bërë prej tij në Vendimin Kornizë se dëmin duhet ta ketë pësuar parashtruesi i kërkesës, pra duhet të jetë cenuar mirëqenia e tij ose e saj fizike ose psikologjike ose gjendja e tij ose e saj ekonomike. Kjo mund të përfshijë dëmin që kanë pësuar viktimat që kanë qenë objekt i veprimeve të kryesit ose kryesve (“viktimat e drejtpërdrejta”) ose që kanë pësuar individë me lidhje të afërta personale me viktimën e drejtpërdrejtë të vrarë ose të lënduar nga kryesi ose kryesit (“viktimat e tërthorta”).⁵⁶ Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren më tej se konsiderohet se familjarët e afërt (bashkëshorti, bashkëshortja, prindërit, fëmijët, vëllezërit, motrat) kanë lidhje të ngushtë me viktimën e drejtpërdrejtë,⁵⁷ por edhe familjarët e tjerë që kanë lidhje afeksioni ose vartësie me viktimën mund të konsiderohen se kanë lidhje të ngushtë me ta.⁵⁸ Afërsia e lidhjes që kërkohet të ekzistojë nuk varet nëse viktima e drejtpërdrejtë është vrarë apo lënduar.⁵⁹

⁵⁶ Vendimi Kornizë, para. 34.

⁵⁷ [United Nations Basic Principles on the Right to a Remedy and Reparation for Victims of Gross Violations of International Human Rights Law and Serious Violations of International Humanitarian Law](#) (“UN Basic Principles”), UNGA Resolution 60/147, 16 December 2005, A/RES/60/147: termi “viktimë” përfshin familjarët e afërt ose persona në varësi financiare të viktimës së drejtpërdrejtë.

⁵⁸ Për ngjashmëri, [Lubanga Appeal Decision on Victim Participation](#), para. 32; *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-1813, Trial Chamber I, [Redacted Version of “Decision on ‘Indirect Victims’”](#), 8 April 2009, paras 44, 50; STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01/PT, Pre-Trial Judge, [Decision on Victims’ Participation in the Proceedings](#) (“*Ayyash et al. Decision on Victim Participation*”), 8 May 2012, para. 49; *Prosecutor v. Ayyash*, STL-18-10/PT, Pre-Trial Judge, [Decision Relating to Victims’ Participation in the Proceedings and Their Legal Representation](#) (“2020 *Ayyash Decision on Victim Participation*”), 17 April 2020, para. 26.

⁵⁹ Për ngjashmëri, STL, [Ayyash et al. Decision on Victim Participation](#), para. 50; [2020 Ayyash Decision on Victim Participation](#), para. 26.

51. Në lidhje me llojin e dëmit të pësuar nga viktimat e krimeve, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton këtu se Ligji dhe Rregullorja identifikojnë këtë tre lloje dëmi: fizik, mendor dhe material.⁶⁰

52. Dëmi fizik është çdo lloj lëndimi trupor, si plagë, fraktura, shfityrim, gjymtim, humbje ose mosfunksionim i organeve, dëmtim, çrregullim, sëmundje ose vdekje.⁶¹ Edhe pse nuk është nevoja që lëndimi trupor të jetë i rrezikshëm për jetën apo i përhershëm, duhet ketë një natyrë ose rëndësi të tillë që të ndikojë në shëndetin ose mirëqenien e viktimës.⁶² Krahas kësaj, viktimat e tërthorta duhet të dëshmojnë se dëmi fizik që kanë pësuar është rezultat i dëmit të pësuar nga viktima e drejtpërdrejtë. Kjo mund të ndodhë kur vuajtja e rëndë ose e zgjatur emocionale e viktimës së tërthortë, për shkak të vdekjes së viktimës së drejtpërdrejtë apo të dëmit të pësuar nga viktima e drejtpërdrejtë, çon në dëmtime fizike ose lëngim.⁶³

53. Dëmi mendor është çdo lloj vuajtjeje psikologjike, si pikëllimi, hidhërimi i thellë, çrregullimi i stresit pastraumatik ose lloje të tjera të çrregullimeve, traumave ose shqetësimi psikologjik.⁶⁴ Vuajtja psikologjike duhet të ketë një shkallë të caktuar rëndese; shqetësimi emocional kalimtar nuk cilësohet në vetvete si dëm mendor.⁶⁵ Krahas kësaj, viktimat e tërthorta duhet të dëshmojnë se dëmi mendor që kanë pësuar është rezultat i dëmit të pësuar nga viktima e drejtpërdrejtë. Megjithatë, konsiderohet vuajtje emocionale (pikëllimi, brengosja, hidhërimi i thellë ose shqetësimi) e një

⁶⁰ Neni 22(1) i Ligjit; rregulla 2 e Rregullores. *Shih edhe UN Basic Principles/Parimet bazë të OKB-së*, para. 8, ku thuhet se dëmi mund të përfshijë lëndimin fizik ose mendor, vuajtjet emocionale, humbjen ekonomike ose cenimin material të të drejtave themelore. *Për ngjashmëri*, ICC, [Lubanga Appeal Decision on Victim Participation](#), paras 31-32; STL, [Ayyash et al. Decision on Victim Participation](#), para 63-84.

⁶¹ *Për ngjashmëri*, *Co-Prosecutors v. Kaing*, Case 001, Supreme Court Chamber, [Appeal Judgment](#) ("Duch Appeal Judgment"), 3 February 2012, para. 415. *See also* ICC, *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-320, Pre-Trial Chamber III, [Fourth Decision on Victims' Participation](#) ("Bemba 4th Decision on Victim Participation"), 12 December 2008, para. 70.

⁶² *Për ngjashmëri*, STL, [Ayyash et al. Decision on Victim Participation](#), para. 65.

⁶³ *Për ngjashmëri*, ECCC, [Duch Appeal Judgment](#), para. 417.

⁶⁴ *Për ngjashmëri*, ECCC, [Duch Appeal Judgment](#), para. 415; STL, [Ayyash et al. Decision on Victim Participation](#), para. 77. *See also* ICC, [Bemba 4th Decision on Victim Participation](#), para. 70.

⁶⁵ *Për ngjashmëri*, STL, [2020 Ayyash Decision on Victim Participation](#), para. 41.

viktime të tërthortë si rezultat i vdekjes ose lëndimit të rëndë të një viktime të drejtpërdrejtë, me kusht që të konstatohet në masë të mjaftueshme lidhja e ngushtë midis tyre.⁶⁶

54. Dëmi material është çdo lloj dëmtimi ose humbjeje pronësore ose financiare, si shkatërrimi, dëmtimi ose vjedhja e pronës vetjake, humbja e të ardhurave ose mjeteve të jetesës ose forma të tjera të humbjeve ekonomike.⁶⁷ Dëmtimi ose humbja pronësore ose financiare duhet të ketë një ndikim të qenësishëm në mjetet e jetesës së viktimës, gjithashtu, viktimat e tërthorta duhet të dëshmojnë se dëmi material që kanë pësuar është rezultat i dëmit të pësuar nga viktima e drejtpërdrejtë. Kjo mund të ndodhë kur vdekja e viktimës së drejtpërdrejtë apo dëmi i pësuar nga viktima e drejtpërdrejtë ka shkaktuar humbjen e të ardhurave për viktimën e tërthortë.⁶⁸

55. Në lidhje me dëmin që është rezultat i drejtpërdrejtë i një krimi të përfshirë në aktakuzë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton këtu konstatimin e tij në Vendimin Kornizë se dëmi është rezultat i drejtpërdrejtë i krimit kur, në rrethanat që mbizotëronin në vendin dhe kohën përkatëse dhe duke marrë në konsideratë situatën personale të viktimës, sipas një vëzhguesi objektiv ka shumë të ngjarë që veprimet ose mosveprimet e kryesit ose kryesve do ta shkaktonin këtë dëm.⁶⁹ Nuk është e domosdoshme që krimi të jetë i vetmi shkak i dëmit të pësuar, por duhet që të ketë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në të.⁷⁰ Në veçanti, në lidhje me dëmin fizik ose mendor, parashtruesit e kërkesave që janë viktima të drejtpërdrejta, së paku duhet të tregojnë se ishin të pranishëm në vendin e ngjarjes në kohën përkatëse dhe se ishin

⁶⁶ Për ngjashmëri, ICC, [Lubanga Appeal Decision on Victim Participation](#), para. 32; *Prosecutor v. Ruto et al.*, ICC-01/09-01/11-249, Pre-Trial Chamber II, [Decision on Victims' Participation at the Confirmation of Charges Hearing and in the Related Proceedings](#), 5 August 2011, para. 55; STL, [2020 Ayyash Decision on Victim Participation](#), para. 44.

⁶⁷ Për ngjashmëri, ECCC, [Duch Appeal Judgment](#), para. 415; STL, [Ayyash et al. Decision on Victim Participation](#), para. 72; [2020 Ayyash Decision on Victim Participation](#), para. 37. See also ICC, [Bemba 4th Decision on Victim Participation](#), para. 70.

⁶⁸ Për ngjashmëri, ECCC, [Duch Appeal Judgment](#), para. 417.

⁶⁹ Vendimi Kornizë, para. 39.

⁷⁰ Për ngjashmëri, ICC, [Bemba 4th Decision on Victim Participation](#), para. 77.

objekt i veprimeve ose mosveprimeve të kryesit ose kryesve. Në lidhje me dëmin material, parashtruesit e kërkesave që janë viktima të drejtpërdrejta duhet të tregojnë, të paktën se prona ose sendet e tyre ndodheshin në vendin e ngjarjes në momentin përkatëse dhe se janë dëmtuar, shkatërruar ose vjedhur si pasojë e kësaj, ose se humbja e të ardhurave apo mjeteve të jetesës ka ndodhur pas krimit ose ka qenë pasojë e krimit. Pavarësisht nga lloji i dëmit, parashtruesit e kërkesave që janë viktima të tërthorta duhet të dëshmojnë, të paktën se dëmi që kanë pësuar ka qenë pasojë e dëmit të pësuar nga viktima e drejtpërdrejtë me të cilin kanë lidhje të ngushtë personale.⁷¹

56. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se viktimat 01/06, 02/06, 03/06, 04/06 dhe 07/06 kanë pësuar dëm fizik, si plagë, fraktura, shfytyrim dhe dëmtim, dhe dëm mendor, si ankth të zgjatur, traumë të rëndë dhe shqetësim, si rezultat i drejtpërdrejtë i ndalimit të pretenduar në vendet e lartpërmendura të krimeve dhe i keqtrajtimit fizik dhe psikologjik që pretendohet se është shkaktuar nga anëtarët e UÇK-së gjatë të gjithë kohës së ndalimit të tyre në to. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se viktimat 16/06, 17/06, 18/06 dhe 19/06, duke qenë familjarë të afërt të viktimave të drejtpërdrejta përkatëse, kanë pësuar dëm mendor, si hidhërim i thellë dhe traumë e rëndë, si rezultat i rrëmbimit dhe vrasjes së paligjshme të pretenduar të viktimave të drejtpërdrejta në fjalë, në vendet e lartpërmendura të krimeve.

57. Megjithëse viktima 17/06 pretendon gjithashtu se ka pësuar dëm fizik si pasojë e vdekjes së viktimës së drejtpërdrejtë, informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur nuk mjafton për një konstatim *prima facie* se një dëm i tillë fizik ka qenë rezultat i vuajtjeve emocionale të viktimës 17/06 pas vdekjes së familjarit në fjalë. Megjithëse viktimat 01/06, 02/06, 03/06 dhe 04/06 gjithashtu pretendojnë se kanë pësuar dëm material, informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur nuk mjafton për një konstatim *prima facie* se një dëm i tillë ka qenë rezultat i drejtpërdrejtë i krimeve të pretenduara.

⁷¹ Për ngjashmëri, STL, , [2020 Ayyash Decision on Victim Participation](#) para. 27.

Këto konstatime nuk cenojnë asnjë vendim të ardhshëm, pas dorëzimit të materialeve shtesë, në lidhje me këto çështje.

(d) Përfundim

58. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se ekzistojnë prova *prima facie* se viktimat 01/06, 02/06, 03/06, 04/06, 07/06, 16/06, 17/06, 18/06 dhe 19/06 kanë pësuar dëm si rezultat i drejtpërdrejtë i një krimi të pretenduar në Aktakuzën e Konfirmuar. Mbështetur në këtë, këta parashtrues kërkesë pranohen në proces si viktima pjesëmarrëse.

59. Gjykatësi i Procedurës Paraprake e shtyn për më vonë vendimin mbi kërkesën e viktimës 12/06 dhe e udhëzon ZPV-në t'i drejtohet parashtruesit të kërkesës për të marrë më shumë informacione lidhur me rrethanat e krimit të pretenduar.

60. Më tej, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se viktimat 06/06, 08/06, 09/06, 10/06, 11/06, 13/06 dhe 14/06, për arsyet e paraqitura në paragrafin 48, nuk pranohen në proces si viktima pjesëmarrëse.

C. MASAT MBROJTËSE

61. ZPV-ja parashtron se pesë parashtrues kërkesë kanë kërkuar mosnxjerrjen publike të informacionit,⁷² një parashtrues kërkesë ka kërkuar mosnxjerrjen e informacionit të akuzuarve,⁷³ katër parashtrues kërkesë kanë kërkuar mosnxjerrjen e informacionit publikut dhe të akuzuarve⁷⁴ dhe tetë parashtrues kërkesë kanë kërkuar mosnxjerrjen e informacionit publikut, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre.⁷⁵ ZPV-ja më tej parashtron se shqetësimet lidhur me një atmosferë të rrezikshme të frikësimit të

⁷² Raporti i parë, para. 56, në lidhje me viktimat 01/06, 02/06, 03/06, 04/06 dhe 05/06.

⁷³ Raporti i parë, para. 56, në lidhje me viktimën 19/06.

⁷⁴ Raporti i parë, para. 56, në lidhje me viktimat 06/06, 09/06, 10/06 dhe 11/06.

⁷⁵ Raporti i parë, para. 56, në lidhje me viktimat 07/06, 08/06, 12/06, 13/06, 14/06, 16/06, 17/06 dhe 18/06.

viktimave në Kosovë dhe faktin se Kosova është një vend i vogël, ku njerëzit jetojnë në komunitete të lidhura ngushtë dhe të akuzuarit kanë influencë dhe burime të mëdha, ndikojnë te të gjitha viktimat që kërkojnë pjesëmarrje.⁷⁶ Për këtë arsye, ZPV-ja parashtron se ekzistojnë rreziqe objektivisht të përligjshme që u kanosen të gjithë parashtruesve të kërkesave, pa pasur nevojë që ata të përmendin kërcënimet konkrete kundër tyre ose familjeve të tyre. Rrjedhimisht, nxjerrja e të dhënave identifikuese të tyre do të përbënte rrezik për parashtruesit e kërkesave dhe familjarët e tyre.⁷⁷ Për këtë arsye, ZPV-ja rekomandon që të dhënat identifikuese të të gjithë parashtruesve të kërkesave të mos i bëhen të ditura publikut dhe që gjithashtu të dhënat identifikuese të parashtruesve të kërkesave me banim në Kosovë dhe të parashtruesve të kërkesave me kombësi shqiptare me familje në Kosovë, të mbahen anonime për mbrojtësit e të akuzuarve dhe të akuzuarit.⁷⁸

62. Mbrojtja parashtron se kërkesa e ZPV-së për anonimitet të plotë të gjashtë parashtruesve të kërkesave duhet refuzuar, duke qenë se ekzistenca e një atmosfere të përgjithshme të ndërhyrjes të dëshmitarët nuk mjafton për të demonstruar një rrezik objektivisht të arsyetueshëm ndaj parashtruesve të kërkesave apo për të përligjur anonimitetin e kërkuar, në mungesë të pretendimeve për kërcënim konkret apo rrezik real ndërhyrjeje.⁷⁹ Mbrojtja kërkon më tej që Mbrojtjes t'i vihen në dispozicion kërkesat e atyre parashtruesve të kërkesave të cilët tashmë janë intervistuar nga ZPS-ja si dëshmitarë, materiali i të cilëve i është nxjerrë Mbrojtjes dhe/ose të cilët përmenden në Aktakuzën e Konfirmuar apo në Përmbledhjen e ZPS-së sipas rregullës 86(3)(b).⁸⁰ Së fundi, Mbrojtja e z. Krasniqi parashtron se masat që lejojnë nxjerrjen e informacionit mbrojtësve, por jo të akuzuarve, nuk janë të pajtueshme me të drejtat e të akuzuarve

⁷⁶ Raporti i parë, para. 59.

⁷⁷ Raporti i parë, para. 60.

⁷⁸ Raporti i parë, para. 61-62.

⁷⁹ Përgjigjja e Thaçit, para. 28; Përgjigjja e Krasniqit, para. 31(c).

⁸⁰ Përgjigjja e Thaçit, para. 25. *Shih edhe* Përgjigjja e Krasniqit, para. 31(f).

dhe bien ndesh me rregullat etike shtetërore të zbatueshme për avokatët që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Angli dhe Uells.⁸¹

63. ZPS-ja parashtron se nuk ka kundërshtim për masat e kërkuara mbrojtëse dhe se çdo kërkesë për nxjerrje informacioni është e parakohshme dhe, gjithsesi, bie ndesh me kornizën e zbatueshme.⁸²

(a) Formularët e kërkesës

64. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton që në fillim se rregulla 113(1) e Rregullores shprehimisht parashikon që formularët e kërkesës nuk u bëhen të njohura palëve. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se funksioni i një formulari kërkesë është të japë informacion lidhur me pranueshmërinë e parashtruesit të kërkesës si VPP, përfshirë përshkrimin e dëmit të pësuar nga viktimi.⁸³ Si rrjedhojë, formulari i kërkesës normalisht përmban shumë informacione delikate të cilat jo domosdoshmërisht kanë lidhje me aspekte provuese. Për këtë arsye, formularët e kërkesës në vetvete nuk janë objekt i nxjerrjes së informacionit për palët.⁸⁴

65. Lidhur me kërkesën e Mbrojtjes për nxjerrje të menjëhershme të të gjitha kërkesave të dëshmitarëve që mund të kenë status të dyfishtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren më tej se, në këtë fazë të procesit, kur ZPS-ja nuk i ka përmbyllur ende detyrimet e veta për nxjerrjen dhe nuk është vendosur në dispozicion një listë dëshmitarësh, kërkesa për nxjerrjen e çdo informacioni që përmbajnë formularët e

⁸¹ Përgjigjja e Krasniqit, para. 31(e).

⁸² Përgjigjja e ZPS-së, para. 1.

⁸³ *Për ngjashmëri*, ICC, *Prosecutor v. Ntaganda*, ICC-01/04-02/06-211, *Pre-Trial Chamber II*, [Decision on Victims' Participation at the Confirmation of Charges Hearing and in Related Proceedings](#), 15 January 2014, para. 43; [Ntaganda Decision on Victims' Participation](#), para. 36.

⁸⁴ *Për ngjashmëri*, STL, *Prosecutor v. Ayyash et al.*, STL-11-01-PT, *Pre-Trial Judge*, [Decision on Prosecution's Request for the Reclassification as Confidential of the Identities and Application of Victims seeking to Participate in the Proceedings](#) ("*Ayyash et al. Decision on Application Forms*"), 31 May 2013, para. 44-49.

kërkesave të parashtruesve të kërkesave viktime “që mund të thirren nga ZPS-ja si dëshmitarë në proces”⁸⁵ është padyshim e parakohshme.

66. Për këto arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se duhet ruajtur klasifikimi rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* i formularëve përkatës të kërkesës dhe i dokumentacionit mbështetës si dhe, rrjedhimisht, e rrëzon kërkesën e Mbrojtjes për nxjerrjen e formularëve të kërkesës.

(b) Parashtruesit e kërkesave të pranuar

67. Sa u takon viktimave 01/06, 02/06, 03/06, 04/06, 07/06, 16/06, 17/06, 18/06 dhe 19/06, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren që në fillim se, siç thuhet në Vendimin Kornizë, kushti ligjor që zbatohet për masat mbrojtëse në lidhje me dëshmitarët është i zbatueshëm edhe sa u takon VPP-ve.⁸⁶ Pavarësisht nga kjo, në marrjen e masave të duhura mbrojtëse lidhur me VPP-të, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh se (i) qëllimi i pjesëmarrjes së viktimave është t’u japë mundësi VPP-ve të ndjekin të drejtat dhe interesat personale të tyre siç parashikohet në Ligj dhe në Rregullore; dhe se (ii) një qëllim i tillë duhet mbajtur parasysh edhe në lidhje me masat mbrojtëse që duhen urdhëruar për VPP-të, pa cenuar asnjë masë tjetër shtesë që rrjedh nga statusi i mundshëm i dyfishtë i tyre. Konstatimet e mëposhtme nuk cenojnë asnjë vendim procedural të ardhshëm të trupit gjykues në këtë aspekt.

68. Sa i takon ekzistencës së një rreziku objektivisht të arsyetueshëm dhe domosdoshmërisë së masave mbrojtëse, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh faktorët e veçantë të rrezikut që janë të zbatueshëm për një ose më shumë prej VPP-ve, duke pasur parasysh se: (i) të gjithë vazhdojnë të vuajnë nga trauma fizike dhe/ose mendore si pasojë e keqtrajtimit që kanë pësuar vetë ose një familjar i afërt i tyre; (ii) të gjithë kanë shprehur frikë ose shqetësim për sigurinë e tyre ose të

⁸⁵ Përgjigja e Thaçit, para. 25.

⁸⁶ Vendimi Kornizë, para. 47.

familjarëve të tyre, nëse do të bëhej e ditur pjesëmarrja e tyre; dhe (iii) [REDAKTUAR]. Gjatë marrjes së vendimit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr në konsideratë edhe: (i) atmosferën e përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve ose viktimave që mbizotëron në Kosovë, sidomos në proceset penale kundër ish-anëtarëve të UÇK-së;⁸⁷ dhe (ii) mjetet dhe se motivin e të akuzuarve për t'i frikësuar këto viktimat, po të kemi parasysh postet me pushtet që kanë mbajtur gjatë periudhës kohore të akuzave, si edhe në periudha më të fundit, çka mund të shndërrohej në rrezik frikësimi të ushtruar nga anëtarët e rrjetit më të gjerë të të akuzuarve.⁸⁸ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh se (i) për shkak të statusit si VPP, këta individë janë sidomos të cenueshëm dhe çdo masë mbrojtëse do të duhej t'u jepte përgjigje nevojave të tyre të veçanta si viktimat; dhe (ii) masat adekuate mbrojtëse për viktimat shpesh janë mjeti juridik përmes të cilit mund të sigurohet pjesëmarrja e tyre në proces, sepse masa të tilla janë një hap i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e viktimave në pajtim me rregullën 80 të Rregullores.⁸⁹ Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se nxjerrja në publik dhe te palët i çdo materiali apo informacioni që çon në identifikimin e VPP-ve të lartpërmendura përbën një rrezik objektivisht të arsyetueshëm për viktimat dhe për familjarët e tyre dhe, rrjedhimisht, konstaton se në këtë fazë të procesit anonimiteti i parashikuar në rregullën 80(4)(e)(i) të Rregullores është masa më e përshtatshme dhe e nevojshme.

69. Sa i takon proporcionalitetit të këtyre masave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rithekson se, në fazën e tanishme të procesit, kur ZPS-ja nuk ka paraqitur ende një listë të dëshmitarëve sipas rregullës 95(4) të Rregullores, është sidomos e parakohshme t'u

⁸⁷ Raporti i parë, para. 59. *Shih edhe* KSC-BC-2020-06, F00027/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni i redaktuar publik i vendimit mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhrat për transferim* ("Vendimi mbi arrestimin dhe paraburgimin"), 26 tetor 2020, publik, para. 29-30, 33-34, 37-38, 41-42; [REDAKTUAR].

⁸⁸ Raporti i parë, para. 59; *Shih edhe* Vendimi mbi arrestimin dhe paraburgimin, paragrafët 29-30, 33-34, 37-38, 41-42; [REDAKTUAR].

⁸⁹ *Për ngjashmëri*, ICC, [Lubanga Decision on Victim Participation](#), para. 128.

kushtohet vëmendje argumenteve lidhur me statusin e mundshëm të dyfishtë të VPP-je. Sa u takon masave të përshtatshme kompensuese, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nënvizon se masat mbrojtëse të miratuara për VPP-të janë të pavarura nga masat mbrojtëse të kërkuara apo të miratuara në lidhje me dëshmitarët dhe nuk ndikojnë në këto masa. Për këtë arsye, statusi i dyfishtë i mundshëm i ndonjë prej VPP-ve ka, në këtë moment, ndikim minimal në mundësinë e Mbrojtjes për t'u përgatitur në lidhje me dëshmitë e ardhshme.⁹⁰ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se çdo masë mbrojtëse e urdhëruar në lidhje me VPP-të e lartpërmendura në këtë fazë nuk cenon ndryshimin e masave të tilla në një fazë të mëpasshme, përfshirë edhe nga trupi gjykues, nëse lind nevoja dhe kur të lindë kjo nevojë.⁹¹ Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se anonimiteti sipas rregullës 80(4)(e)(i) të Rregullores është një masë proporcionale në këtë fazë të procesit.

70. Duke u bazuar në sa më sipër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron që emrat dhe të dhënat identifikuese të viktimave 01/06, 02/06, 03/06, 04/06, 07/06, 16/06, 17/06, 18/06 dhe 19/06 të mos i bëhen të ditura publikut dhe palëve dhe, për pasojë, e gjykon të përshtatshme ruajtjen e klasifikimit rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* të përmbledhjeve të kërkesave përkatëse.

(c) Parashtruesit e kërkesave të refuzuara

71. Sa u takon viktimave 06/06, 08/06, 09/06, 10/06, 11/06, 13/06 dhe 14/06 Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se, nisur nga konfidencialiteti i procesit të paraqitjes së kërkesave, siç përcaktohet në rregullën 113(1)-(2) të Rregullores, dhe duke mbajtur parasysh mbrojtjen e privatësisë së parashtruesve të kërkesës, është e domosdoshme që emrat dhe të dhënat identifikuese të tyre të mos u bëhen të ditura

⁹⁰ Për ngjashmëri, ICC, *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15-471, Trial Chamber IX, [Decision on Disclosure of Victims' Identities](#) ("Ongwen Decision on Victims' Identities"), 17 June 2016, para. 11.

⁹¹ Për ngjashmëri, ICC, [Ongwen Decision on Victims' Identities](#), para. 12-14.

palëve dhe publikut. Duke pasur parasysh se asnjëri prej parashtruesve të kërkesave nuk është pranuar si VPP, mosnxjerrja e të dhënave nuk cenon të akuzuarit apo gjykimin e drejtë.

72. Mbështetur në këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron që emrat dhe çdo e dhënë identifikuese e viktimave 06/06, 08/06, 09/06, 10/06, 11/06, 13/06 dhe 14/06 të mos u bëhen të ditura palëve dhe publikut dhe, për pasojë, e gjykon të përshtatshme ruajtjen e klasifikimit rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* të përmbledhjeve të kërkesave përkatëse.

D. GRUPIMI DHE PËRFAQËSIMI LIGJOR I PËRBASHKËT

73. Në raportin e parë, ZPV-ja parashtron se, duket se interesat e parashtruesve të kërkesave nuk dallojnë në vetvete sa i takon rezultatit të procesit.⁹² Në Shtesë, ZPV-ja bën të ditur se problemet e mundshme të lidhura me grupimin dhe përfaqësimin e përbashkët që janë identifikuar, kanë të bëjnë me rrethanat e ndryshme të parashtruesve të kërkesave, që janë kombësia, gjuha dhe vendndodhja gjeografike. ZPV-ja parashtron më tej se këta faktorë mund të ndikojnë në përfaqësimin e përbashkët efektiv dhe pjesëmarrjen e njëmendtë, sepse mund të cenonin besimin e nevojshëm midis mbrojtësit të viktimave dhe klientëve dhe të ndikonin negativisht në viktimat pjesëmarrëse me kombësi të ndryshme, nëse grupohen në të njëjtin grup.⁹³ Gjithashtu, ZPV-ja parashtron se ka marrë parasysh edhe pengesat logjistike të kontaktit me disa prej viktimave, çka mund të justifikojnë përfaqësim të tyre më vete.⁹⁴ Pavarësisht nga këto aspekte, ZPV-ja bën të ditur se shumica e parashtruesve të kërkesave nuk kanë kundërshtim të grupohen në një grup të vetëm.⁹⁵ ZPV-ja shton se, pavarësisht nga përkatësia etnike, gjuha amtare dhe nga vendndodhja gjeografike, të

⁹² Raporti i parë, para. 52.

⁹³ Shtesa, para. 13.

⁹⁴ Shtesa, para. 15.

⁹⁵ Shtesa, para. 25.

gjithë parashtruesit e kërkesave mund të konsiderohen viktima të krimeve që pretendohet se janë kryer nga të njëjtën kryes dhe secili prej parashtruesve të kërkesave ka të njëjtin interes të përbashkët për të kërkuar drejtësi para DHS-së.⁹⁶ ZPV-ja parashtron më tej se çdo problem i mundshëm që ndikon në përfaqësimin e përbashkët mund të administrohet me efektivitet duke pasur një ekip juridik me disa anëtarë, me zotësinë për të punuar në gjuhë të ndryshme dhe vende të ndryshme të origjinës.⁹⁷ Mbështetur në këtë, ZPV-ja rekomandon që parashtruesit e kërkesave të grupohen në një grup të vetëm.⁹⁸

74. Mbrojtja e z. Krasniqi parashtron se nuk sheh asgjë në raportin e parë që të tregojë se ka konflikt interesi i cili do të justifikonte ndarjen e parashtruesve të kërkesave në më shumë se një grup dhe se ruan të drejtën të përgjigjet më tej në kohën e duhur.⁹⁹

75. Mbrojtja e z. Thaçi e mbështet rekomandimin e ZPV-së që parashtruesit e kërkesave për pjesëmarrje si viktima të grupohen së bashku në një grup të vetëm për të mundësuar përfaqësimin e përbashkët ligjor të tyre në këtë proces.¹⁰⁰ Mbrojtja e z. Thaçi parashtron më tej se emërimi i një përfaqësuesi të përbashkët ligjor për të gjithë parashtruesit aktualë të kërkesave për pjesëmarrje si viktima është në interesin e një administrimi të drejtë por efikas të drejtësisë dhe se është në përputhje me rregullën 113(8) të Rregullores dhe me Vendimin Kornizë.¹⁰¹

76. Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton këtu konstatimin e bërë prej tij në Vendimin Kornizë sipas të cilit nevoja për t'i ndarë parashtruesit e kërkesave në më shumë se një grup lind atëherë kur situata apo veçoritë e viktimave janë kaq të ndryshme saqë interesat e tyre janë të papajtueshme, gjë që do ta bënte të

⁹⁶ Shtesa, para. 27.

⁹⁷ Shtesa, para. 28.

⁹⁸ Shtesa, para. 29.

⁹⁹ Përgjigjja e Krasniqit, para. 32.

¹⁰⁰ Përgjigjja e Thaçit ndaj Shtesës, para. 5.

¹⁰¹ Përgjigjja e Thaçit ndaj Shtesës, para. 7.

parealizueshëm përfaqësimin e përbashkët.¹⁰² Rrjedhimisht, sa u takon viktimave 01/06, 02/06, 03/06, 04/06, 07/06, 16/06, 17/06, 18/06 dhe 19/06, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se janë të kombësive të ndryshme, banojnë në zona të ndryshme dhe flasin gjuhë të ndryshme. Njëkohësisht, si viktimat e drejtpërdrejta ashtu edhe viktimat e tërthorta kanë vuajtur prej të njëjtave krime nga të njëjtët grupe kryesish dhe kanë pësuar forma të ngjashme dëmi dhe duket se të gjithë duket se kanë një interes të përbashkët për të marrë pjesë në proces dhe për të kërkuar të drejtat e tyre. Gjithashtu, parashtruesit e lartpërmendur të kërkesave kanë bërë të ditur se nuk janë kundër përfshirjes në një grup me viktime të tjera.¹⁰³

77. Mbështetur në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se viktimat 01/06, 02/06, 03/06, 04/06, 07/06, 16/06, 17/06, 18/06 dhe 19/06 duhet të përfaqësohen si një grup VPP-sh (“Grupi 1”).

78. Më tej, Gjykatësi i Procedurës Paraprake kujton edhe se, në pajtim me nenin 22(5) të Ligjit dhe rregullën 113(7) të Rregullores, me t’iu dhënë e drejta për pjesëmarrje në proces, grupet e VPP-ve duhet të ndihmohen dhe të përfaqësohen nga mbrojtës të viktimave dhe se nuk lejohet asnjë përfaqësim tjetër për viktimat. Për këtë arsye, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konsideron të nevojshme të sigurojë përfaqësimin e përbashkët të parashtruesve të kërkesave të pranuar sa më shpejt që të jetë e mundur pas nxjerrjes së këtij vendimi, për të shmangur kështu çdo vonesë të panevojshme në pjesëmarrjen e VPP-ve. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron Administratoren që deri të premtën, datë 7 maj 2021, të caktojë një mbrojtës të viktimave me qëllim përfaqësimin e përbashkët të Grupit 1.

¹⁰² Vendimi Kornizë, para. 43.

¹⁰³ Raporti i parë, Shtojcat 2-6, 8, 16-19; Shtesa, para. 25.

E. PJESËMARRJA NË PROCEDURËN PARAPRAKE

79. Mbrojtja parashtron që Gjykatësi i Procedurës Paraprake t'u kërkojë mendim palëve për të drejtat për pjesëmarrje të VPP-ve në fazën e procedurës paraprake, mbështetur në statusin e tyre, duke pasur parasysh se kuadri i pjesëmarrjes ndryshon në varësi të masave mbrojtëse dhe të statusit të mundshëm të dyfishtë si VPP dhe si dëshmitarë.¹⁰⁴

80. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbështetet në argumentimin e vet të mësipërm se masat mbrojtëse që miratohen për VPP-të në këtë fazë kanë ndikim minimal në mundësinë e Mbrojtjes për t'u përgatitur në lidhje me dëshmitë e ardhshme¹⁰⁵ dhe, rrjedhimisht, është i mendimit se modalitetet e pjesëmarrjes së VPP-ve në procedurën paraprake nuk janë në varësi të llojit të masave mbrojtëse të miratuara.¹⁰⁶ Së fundi, në pajtim me rregullën 114(4) të Rregullores, është prerogativë e Gjykatësit të Procedurës Paraprake të lëshojë udhëzime konkrete në lidhje me pjesëmarrjen e viktimave në procedurën paraprake.

81. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se, në përputhje me nenin 22 të Ligjit dhe me rregullën 114 të Rregullores, VPP-të duhet t'i ushtrojnë të drejtat e tyre nëpërmjet mbrojtësit të viktimave dhe të marrin pjesën në procedurën paraprake sipas modaliteteve të përshkruara më poshtë. Duhet theksuar se modalitetet e parashtruara në vijim në çdo kohë janë brenda kompetencës së Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Të drejtat për pjesëmarrje mund të ndryshohen në raste të veçanta, nëse nuk cenohen interesat personale të VPP-ve ose nëse e kërkojnë arsye të tjera.

82. Së pari, në pajtim me rregullën 114(3) të Rregullores, mbrojtësi i viktimave ka të drejtë të shohë të gjithë dosjen e çështjes, përfshirë të gjitha parashtrimet e

¹⁰⁴ Përgjigjja e Thaçit, para. 29; Përgjigjja e Krasniqit, para. 31(d).

¹⁰⁵ *Shih më lart* para. 69.

¹⁰⁶ *Për ngjashmëri*, ICC, [Bemba 4th Decision on Victim Participation](#), para. 99.

protokolluara, transkriptet dhe materialet provuese të klasifikuara si publike dhe konfidenciale, me përjashtim të materialeve *ex parte* të dosjes së çështjes. Po kështu, mbrojtësi i viktimave informohet për të gjitha materialet e shpërndara që i përkasin dosjes së çështjes, ku përfshihen të gjitha parashtrimet e protokolluara, transkriptet dhe nxjerrjet e materialeve provuese, me përjashtim të materialeve të shpërndara *ex parte* të dosjes së çështjes. Mbrojtësi i viktimave nuk ka të drejtë të shohë apo të informohet për materiale rreptësisht konfidenciale ku përfshihen parashtrime të protokolluara, transkripte apo materialet provuese, nëse nuk parashtrohet specifikisht ndryshe. Mbrojtësi i viktimave i mban VPP-të të informuara për zhvillimet përkatëse të çështjes në mënyrë të tillë që të mos zbulojë informacione jopublike.

83. Së dyti, në pajtim me nenin 22(6) të Ligjit dhe rregullën 114(2) të Rregullores, dhe me qëllim që të garantohet përfaqësimi i duhur në çdo kohë i interesave personale të VPP-ve, mbrojtësi i viktimave është i pranishëm në të gjitha seancat e procedurës paraprake, me përjashtim të seancave *ex parte*.

84. Së treti, në pajtim me nenin 22(6) të Ligjit dhe rregullën 114(4) të Rregullores, mbrojtësit të viktimave i lejohet të bëjë parashtrime gojarisht dhe me shkrim sa herë që preken interesat personale të VPP-ve. Për të siguruar një modalitet të pjesëmarrjes pa pengesa dhe efikas, mbrojtësit të viktimave nuk i kërkohet të kërkojë leje paraprakisht për paraqitjen e parashtrimeve gojarisht dhe me shkrim, por i kërkohet të bëjë të ditur në parashtrimin në fjalë se cili interes i veçantë personal preket.

V. VENDIMI

85. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **MIRATON** kërkesat e viktimave 01/06, 02/06, 03/06, 04/06, 07/06, 16/06, 17/06, 18/06 dhe 19/06 dhe i pranon këta parashtrues kërkesë në procedurë si VPP;

- b. **VENDOS** që viktimat 01/06, 02/06, 03/06, 04/06, 07/06, 16/06, 17/06, 18/06 dhe 19/06 të përfaqësohen si Grupi 1;
- c. **URDHËRON** Administratoren që brenda të premtës, datë 7 maj 2021, të caktojë një mbrojtës të viktimave me qëllim përfaqësimin e përbashkët të Grupit 1;
- d. **VENDOS** që mbrojtësi i viktimave i caktuar si më lart:
- i. të ketë të drejtë të shohë të gjithë dosjen e çështjes, përfshirë të gjitha parashtrimet e protokolluara, transkriptet dhe materialet provuese, të klasifikuara publike dhe konfidenciale, me përjashtim të materialeve *ex parte* të dosjes së çështjes;
 - ii. të ketë të drejtë të njoftohet për të gjitha materialet e shpërndara në dosjen e çështjes, përfshirë të gjitha parashtrimet e protokolluara, transkriptet, nxjerrjet e materialeve provuese të klasifikuara si publike apo konfidenciale, me përjashtim të materialeve *ex parte* të shpërndarë të dosjes së çështjes;
 - iii. të mos ketë të drejtë të shohë e të njoftohet për materialet rreptësisht konfidenciale, përfshirë parashtrime të protokolluara, transkripte apo materiale provuese, nëse nuk parashikohet specifikisht ndryshe;
 - iv. të mbajë të informuar VPP-të për zhvillimet përkatëse të çështjes në mënyrë të tillë që të mos zbulojë informacione jopublike;
 - v. të jetë i pranishëm në të gjitha seancat e procedurës paraprake, me përjashtim të seancave *ex parte*;
 - vi. të lejohet të bëjë parashtrime gojarisht dhe me shkrim sa herë që preken interesat personale të VPP-ve, siç përcaktohet në paragrafin 84;
- e. **SHTYN** marrjen e vendimit për kërkesën e viktimës 12/06 dhe **URDHËRON** ZPV-në t'i parashtrtojë Gjykatësit të Procedurës Paraprake

informacion shtesë, nëse ka, siç përcaktohet në paragrafin 47, brenda të premtes, 21 maj 2021;

- f. **REFUZON** kërkesat e viktimave 06/06, 08/06, 09/06, 10/06, 11/06, 13/06 dhe 14/06 si të papranueshme;
- g. **URDHËRON** që masa mbrojtëse e anonimitetit sipas rregullës 80(4)(e)(i) të Rregullores të miratohet për viktimat 01/06, 02/06, 03/06, 04/06, 07/06, 16/06, 17/06, 18/06 dhe 19/06;
- h. **URDHËRON** që emrat dhe çdo e dhënë identifikuese e viktimave 06/06, 08/06, 09/06, 10/06, 11/06, 13/06 dhe 14/06 të mos u bëhen të ditura palëve dhe publikut; dhe
- i. **URDHËRON** mbajtjen e klasifikimit të të gjitha përmbledhjeve të kërkesave, formularëve të kërkesave dhe dokumentacionit mbështetës si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E mërkurë, 21 prill 2021
Hagë, Holandë.